



KARTA E TË DREJTAVE TË PACIENTIT

1. E drejta për masa parandaluese

Çdo qytetar ka të drejtë për shërbim të duhur shëndetësor me qëllim të parandalimit të sëmundjeve.

2. E drejta e qasjes

Çdo qytetar ka të drejtën e qasjes së barabartë në shërbimet shëndetësore pa asnjë lloj diskriminimi.

3. E drejta për informim

Çdo qytetar ka të drejtën e qasjes në të gjitha informatat në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore, shërbimet shëndetësore dhe mënyrën si mund t'i shfrytëzojë ato.

4. E drejta për dhënien e pëlqimit

Çdo qytetar ka të drejtën e dhënies së pëlqimit për vendimet që kanë të bëjnë me shëndetin e tij (familjari ose kujdestari i tij në qoftë se gjendja e tij nuk e lejon); ky informacion është një parakusht për çdo procedurë dhe trajtim, duke e përfshirë edhe pjesëmarrjen në kërkime shkencore.

5. E drejta për zgjedhje të lirë

Çdo qytetar ka të drejtë që të konsultohet me dhe të trajtohet nga mjeku të cilin e zgjedh vetë me pëlqimin e institucionit shëndetësor, brenda kufijve të përcaktuar me ligj dhe rregullat operative të institucionit.

6. E drejta për privatësi dhe konfidencialitet

Çdo qytetar ka të drejtën e konfidencialitetit të informatave personale, duke përfshirë informatat lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe procedurat e mundshme diagnostike ose terapeutike.

7. E drejta për respektimin e kohës së pacientëve

Çdo qytetar ka të drejtë ta marrë trajtimin e domosdoshëm brenda një afati sa më të shkurtër kohor. Kjo e drejtë zbatohet në çdo fazë të trajtimit.

8. E drejta për qasje në shërbime cilësore

Çdo qytetar ka të drejtë të ketë qasje në shërbime shëndetësore cilësore duke u bazuar në standardet e cilësisë së lartë.

9. E drejta për siguri

Çdo qytetar ka të drejtë për të mos u dëmtuar nga keqfunksionimi i shërbimeve shëndetësore, praktikat jo të përshtatshme dhe gabimet mjekësore. Po ashtu ka të drejtën e qasjes në shërbime shëndetësore dhe trajtime që janë të sigurta.

10. E drejta për risi

Çdo qytetar ka të drejtë të ketë qasje në procedurat e reja diagnostike sipas standardeve ndërkombëtare.

11. E drejta për shmangie të vuajtjeve dhe dhimbjeve

Çdo qytetar ka të drejtë për të shmangur, sa më shumë të jetë e mundur, dhimbjen dhe vuajtjen në çdo fazë të sëmundjes së tij.

12. E drejta për trajtim personal

Çdo qytetar ka të drejtë për trajtim diagnostik ose terapeutik të përshtatur për nevojat e tij personale.

13. E drejta e ankesës

Çdo qytetar ka të drejtë për t'u ankuar sa herë që pëson dëm fizik, moral ose psikologjik. Po ashtu ka të drejtë për të marrë përgjigje në ankesën e tij.

14. E drejta për kompensim

Çdo qytetar ka të drejtë të marrë kompensim brenda një afati të caktuar kohor sa herë që ka pësuar dëm fizik, moral ose psikologjik të shkaktuar gjatë trajtimit shëndetësor, në pajtim me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor.

POVELJA O PRAVIMA PACIJENATA

1. Pravo na preventivne mere

Svaki građanin polaže pravo na odgovarajuću uslugu u svrhu prevencije bolesti.

2. Pravo na dostupnost

Svaki građanin polaže pravo na dostupnost zdravstvenim uslugama, bez diskriminacije po osnovu rase, pola, nacionalne pripadnosti, mesto boravka i vrste bolesti.

3. Pravo na informaciju

Svaki građanin polaže pravo na pristup sveukupnosti informacija koje se odnose na osnovno zdravstveno stanje, na sve mogućnosti koje pružaju zdravstvene usluge.

4. Pravo na pristanak

Svaki građanin polaže pravo na sve informacije koje mogu omogućiti aktivno sudjelovanje u odlukama o vlastitom zdravlju (član porodice ili staratelj ako mu stanje ne dozvoljava); ove informacije su preduslov za svaki postupak i tretiranje u svrhu liječenja, uključujući i učešće u znanstvenim (naučnim) istraživanjima.

5. Pravo na slobodan izbor

Građanin polaže pravo da bude konsultovan i tretiran od strane lekara na slobodan izbor uz saglasnosti zdravstvene ustanove, u skladu određenog zakona i operativnim pravilima institucije.

6. Pravo na privatnost i poverljivost

Svaki građanin polaže pravo na poverljivost ličnih informacija, uključujući one o vlastitom zdravstvenom stanju i mogućim dijagnostičkim ili terapijskim postupcima.

7. Pravo na poštovanje pacijentovog vremena

Svaki građanin polaže pravo na iziskujući zdravstvenu uslugu, unutar najskorijeg mogućeg i unapred određenog vremenskog termina. Ovo se pravo odnosi na sve etape u trajanju medicinskog postupka.

8. Pravo na pristup kvalitetnim zdravstvenim uslugama

Svaki građanin polaže pravo na visoko kvalitetnu zdravstvenu uslugu u skladu sa vrednovanju na jasno utvrđenim standardima.

9. Pravo na sigurnost

Svaki građanin polaže pravo da ne trpi posledice menadžiranja zdravstvenih usluga, ne odgovarajući postupak i medicinske greške. Građanin ima pravo na pristup zdravstvenim uslugama i tretmanima koji su bezbedni.

10. Pravo na inovacije

Svaki građanin polaže pravo pristupa inovativnim postupcima, uključujući dijagnostičke postupke u skladu sa međunarodnim standardim.

11. Pravo na izbegavanje nepotrebne patnje i boli

Svaki građanin polaže pravo na izbegavanje koliko god je to moguće od nepotrebne patnje i boli u svakoj fazi svoje bolesti.

12. Pravo za individualni tretman

Svaki građanin polaže pravo dijagnostički ili terapijski postupak koji je u najvećoj mogućoj meri prilagođen ličnim potrebama.

13. Pravo na pritužbe

Svaki građanin polaže pravo na pritužbu u svakoj prilici u kojoj doživi fizičku, moralnu i psihološku povredu., tako da građanin polaže pravo na odgovor podnete pritužbe.

14. Pravo na obeštećenje

Svaki građanin polaže pravo na dostatno obeštećenje unutar određenog roka kad god pretrpi fizičku, etičku ili psihološku povredu uzrokovanu zdravstvenom uslugom, u skladu sa Zakonom o pravima i odgovornostima građana u zdravstvenoj zaštiti.

CHARTER OF PATIENTS' RIGHTS

1. Right to preventive measures

Every citizen has the right to proper health service with purpose of diseases prevention.

2. Right of access

Every citizen shall be warranted the right of equal access to health services without discrimination on racial, gender, ethnicity, place of residence and type of disease.

3. Right to information

Every citizen has the right to access all information about his state of health, health services and how to use them.

4. Right to consent

Every citizen has the right to give consent to decisions dealing with his health (family member or guardian if his condition does not allow), this information is a prerequisite for any procedure and treatment, including participation in scientific research.

5. Right to free choice

A citizen has the right to be consulted and be treated by a doctor of his choice with the consent of the health institution within the boundaries provided by law and operational rules of the institution.

6. Right to privacy and confidentiality

Every citizen has the right to confidentiality of personal information, including information concerning his health and potential diagnostic or therapeutic procedures.

7. Right to respect of patients' time

Every citizen has the right to receive necessary treatment within the shortest time period. This right applies at each stage of treatment.

8. Right to the observance of quality standards

Every citizen has the right to have access to high quality health services based on high quality standards.

9. Right to safety

Every citizen has the right not to be affected by the malfunction of health services, inadequate practices and medical mistakes. He also has the right of access to health services and treatments that are safe.

10. Right to innovation

Every citizen has the right to have access to new diagnostic procedures according to international standards.

11. Right to avoid unnecessary suffering and pain

Every citizen has the right to avoid as much as possible pain and suffering at every stage of his illness.

12. Right to personalized treatment

Every citizen has the right to diagnostic or therapeutic treatment adjusted to his personal needs.

13. Right to complain

Every citizen has the right to complain whenever he or she suffers physical, moral and psychological harm. He is also entitled to receive a response to his complaint.

14. Right to compensation

Every citizen is entitled to receive compensation in a timely manner whenever he suffered physical, moral or psychological harm caused during treatment, in accordance with the Law on Rights and Responsibilities of Citizens in Health Care.

KARTA E PËRGJEGJËSIVE TË PACIENTIT

1. Nëse e lejon gjendja e tij shëndetësore, qytetari varësisht nga aftësitë dhe njohuritë e tij duhet të bashkëpunojë me profesionistët shëndetësorë, të përfshirë në trajtimin mjekësor, në mënyrat siç vijojnë:

a. informimi mbi të gjitha detajet e domosdoshme për përcaktimin e diagnozës, posaçërisht informimi i profesionistëve shëndetësorë, për çdo sëmundje të mëhershme, trajtim shëndetësor, përdorim të barnave si dhe për afinitetin e tij ndaj faktorëve të rrezikshëm, që mund ta dëmtojnë shëndetin;

b. informimi për çdo detaj në lidhje me sëmundjen e tij që mund ta rrezikojë sigurinë jetësore ose fizike të të tjerëve, në veçanti mbi ndonjë sëmundje ngjitëse apo ndonjë gjendje që e përjashton atë nga ushtrimi i profesionit;

c. t'u përmbahet udhëzimeve të dhëna në lidhje me trajtimin mjekësor;

d. respektimi i rregullave operative të institucionit shëndetësor;

e. përmbushja e obligimeve (pagesave) për shërbimet e pranuar;

f. prezantimi i provave të besueshme për të dhënat personale.

2. Gjatë ushtrimit të të drejtave të qytetarit, ai ose të afërmit e tij, duhet t'i respektojnë të drejtat e qytetarëve të tjerë.

3. Gjatë ushtrimit të të drejtave të përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ, ndaloheq që qytetari ose të afërmit e tij t'i çenojnë të drejtat e personelit shëndetësorë.

POVELJA ODGOVORNOSTI PACIJENATA

1. Ako dopušta zdravstveno stanje građanina, shodno sposobnostima i znanja, treba da sarađuje sa zdravstvenim radnicima, koji su uključeni u lečenje na sledeće načine :

a. informiše o svim potrebnim detaljima za postavljanje dijagnoze, posebno informisanje zdravstvenih radnika, o svim prethodnim bolestima, lečenju, primljenim lekovima sa sličnim faktorima rizika koje utiču na zdravlje ;

b. detalno obaveštava u vezi svoje bolesti, koji može da ugrozi život ili fizičku bezbednost ostalih, a posebno od zaraznih bolesti ili bilo neko drugo stanje koji sprečava da obavlja zanimanje.

c. pridržava se dobijenih uputstva u vezi sa medicinskim tretmanom;

d. poštovanje operativna pravila institucije zdravstvene zaštite ;

e. primljene usluge potrebno je platiti;

f. dostavlja verodostojne isprave o ličnim podacima;

2. U vršenju svojih prava, građani i njihovi rođaci moraju poštovati prava drugih građana.

3. U vršenju prava koje su određene ovim AU, građani ili njihovi rođaci ne smeju da krše prava zdravstvenog osoblja.

Pravo na pritužbe preko telefona

Svaki građanin polaže pravo na pritužbu preko telefonske veze Br. 080017777, gratis tokom 24 sata pri Ministarstvo Zdravstva.

Right to file complaints through phone

Every citizen has the right to file a complaint through phone connection No.080017777, for free 24 hours in the Ministry of Health

E drejta e ankesës përmes telefonit

Çdo qytetar ka të drejtë të paraqesë ankesë përmes lidhjes telefonike Nr.080017777, falas gjatë 24 orëve në Ministrinë e Shëndetësisë.